



“ILLYRIAN GUARD” SH.A

Miratohet

ADMINISTRATORI

Robert LILI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, me _____.____.2023

PROCES VERBAL datë __.__.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **OBJEKTI I PROCEDURËS: “LCD Wall për sallën operative”**
- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
32351200-0 - EKRANE,**
- **VLERA E FONDIT LIMIT: 9,994,575 (Nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) LEK PA TVSH**
- Sigurimi i ofertës 2% 199,891.5 e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të urdhërit të prokurimit Nr. Prot 930/16, Nr. 650, datë 07.06.2023, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **“LCD Wall për sallën operative”** për nevojat e shoqërisë **“Illyrian Guard”** Sh.A ju informojmë për sa më poshtë:

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit të propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të fondit limit

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 43, pikA 1 tw VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar Nenit 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket kapacitetit teknik, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shenohen, vlera, afati i perfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do të vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë dhe të paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si më poshtë:

ISO 20000-1 mbi “Menaxhimin e shërbimit” ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. Përmbushja e standartit ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.

Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” ShA. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standartit kompanitë aplikojnë praktikën më të mirë, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Nisur nga proceset e punës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, t’i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë e kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatori ekonomikë që do të zbatojë kontratën të jetë i certifikuar në sigurinë e informacionit.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e të dhënave në mënyrën e duhur. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmbush standartet për sigurinë e informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë .

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për produktet e ofruara.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për furnizimin/suportin e pajisjeve që do të përdoren për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë për të gjitha pajisjet si më poshtë:

- **EKRAN LCD 55 INCH**
- **LCD-WALL KONTROLLER “DECODER”**

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me

treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Autorizimet e Prodhuarit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomike kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues. Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) skedë teknike (datasheet) të lëshuar nga prodhuesi i mallrave që oferton për produktet si më poshtë (të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor).

- **EKRAN LCD 55 INCH**
- **LCD-WALL KONTROLLER “DECODER”**

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 6 pika b të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë të artikujve që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të përcaktuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë që produktet e përmendura ne piken 2.3.4 janë prodhim që plotëson standartet e komunitetit europian duke paraqitur ne sistem elektronikisht certifikatën/deklaratat e konformitetit .

Argumentim: Deklarata e konformitetit është një document i rëndësishëm, pasi na garanton se malli i ofertuar është në përputhje me standartet europiane. Ky kriter është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 6 c, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 OE për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për muajin e fundit, të paktën 5 (pesë) persona të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e kërkuar.

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar vërtetuar me listepagesat E-sig , si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me Certifikatë për Menaxhim Projektsh PMP , për të cilin OE duhet të paraqesë certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listepagesa për periudhën e kërkuar;
- Të paktën 1 (një) inxhinier të profileve Elektrik – për të cilin duhet të paraqitet diploma e arsimit të lartë, origjinale ose të noterizuara/ Vërtetim diplomimi sipas ligjit dhe të figurojnë në listepagesa për periudhën e kërkuar.
- Të paktën 1 (një) inxhinier të profileve Elektronik/ Telekomunikacioni /TIK /Informatikë– për të cilin duhet të paraqitet diploma e arsimit të lartë, origjinale ose të noterizuara/ Vërtetim diplomimi sipas ligjit dhe të figurojnë në listepagesa për periudhën e kërkuar.
- Të paktën 2 (dy) montues/ instalatorë/ teknik elektronik për montimin e pajisjeve elektronike- duhet të figurojnë në listepagesa për periudhën e kërkuar dhe të jenë të deklaruar me kodin përkatës të profesionit.

- Të paktën 1 (një) nga punonjësit e mësipërm duhet të zotërojë një certifikatë kualifikimi nga kompania prodhuese e LCD Wall-it Kontroller “Decoder”

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Listë pagesat sipas formatit E-sig për muajin e fundit.
- Diplomat e arsimit të lartë të kërkuara, origjinale ose të noterizuara/ Vërtetim diplomimi sipas ligjit, Certifikatat përkatëse të kursit apo trajnimit
- Kontratat e punës

***Një punonjës mund të ketë me shumë se 1 një certifikime/trajnime.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.

Argumentim:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Për të vërtetuar që Operatori Ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit. Inxhinierët dhe montuesit /tekniket e pajisjeve elektronike janë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen nga OE në instalimin e pajisjeve, konfigurimin e tyre dhe integrimin në rrjetet ekzistuese, ndaj nevojitet certifikimi nga prodhuesi i pajisjeve që do të instalojnë, konfigurojnë.

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër realizimin e kontratës sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikime teknike.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funktionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t’i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektsh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit